



01/Nr. 5228/2024  
Data : 10.06.2024

## PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e pestë -V- për vitin 2024 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 21.05.2024 me fillim pune ne ora 13:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoresh për Kulturë Rini dhe Sport), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim), **Rezart Mehmeti** (Përfaqësues i OSB-së).

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.
3. Raporti i tubimit zgjedhorë për përzgjedhjen e këshillit lokal të Hanit të Elezit, Uji Thartë, Lagjja e Re, Laç dhe Dimcë.
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- e keni informatën mbi gjendjen në mjedis dhe raportin vjetorë të kompanisë Sharrcem. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim mundeni me parashtruar.

**Sherif Berisha** thekson:- a keni vepruar diçka rreth ndotjes së asfaltit që është bërë ditëve të fundit.

**Nexhmedin Daci** thekson:- ndotje bëhet jo vetëm prej qarkullimit të veturave por edhe prej qarkullimit që bëhet. Me ligj magjistratja është në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës por komuna nuk i ka mundësit që me dalë me pastruar rrugët.

**Kryesuesi** thekson:- është fakt që si komunë nuk e kemi për obligim për me mirëmbajtur por është e arsyeshme dhe e drejtë me bërë një pastrim të rrugës.

**Hyriete Isufi** thekson:- te investimet kapitale shënon mbjell e 200,000 fidaneve në Seçishtë por mendoj që është gabim teknikë dhe duhet të përmirësohet.

**Abduraman Bushi** thekson:- janë mbjellë 20 000 fidane dhe një pjesë bukur e madhe nuk kanë zënë dhe për pjesën që kanë zënë do ta kemi problem mirëmbajtjen për shkak të mundësive që i kemi por do t'i shikojmë mundësitë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U VOTU INFORMATA MBI MBROJTJEN E MJEDISIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

## 3. Raporti i tubimit zgjedhorë për përzgjedhjen e këshillit lokal të Hanit të Elezit, Uji Thartë, Lagjja e Re, Laç dhe Dimcë.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyra Kalisi** thekson:- raporti është hartuar në bazë të rregullores komunale për bashkëpunimin me këshillat e fshatrave dhe komisioni i themeluar prej kuvendit duhet t'i raportoj kuvendit për procesin zgjedhorë. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Xhevahir Dernjani** thekson:- kemi marr pjesë si komisionë për zgjedhjen e kryetarit të këshillit për Han të Elezit dhe si komision që kemi marr pjesë themi se gjithçka ka shkuar në rregull.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U VOTU RAPORTI I TUBIMIT ZGJEDHORË PËR PËRZGJEDHJEN E KËSHILLIT LOKAL TË HANIT TË ELEZIT UJI THARTË LAGJA E RE DHE DIMCË QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

## 5. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- me çfarë baze është liruar profesori në pushim pa pagesë apo në pushim mjekësorë . Te rruga Hani i Elezit Gorancë ka rënë shi dhe është mirë me shtruar rërë.

**Kryesuesi** thekson:- gropat të cilat janë bërë nëpër qytet kush e ka për detyrë me i rregulluar.

**Arsim Dernjani** thekson:- gropat janë bërë nga kompania Bifrukacioni dhe jam në kontakte me përfaqësuesit e kompanisë Bifrukacioni dhe kanë premtuar që kanë me i rregulluar. Ne kemi në plan me shpall procedurë për këtë çështje por para muajit qershor nuk mundemi me i shpallur por do të rregullohen edhe pjesët tjera ku janë dëmtuar.

**Sherif Berisha** thekson:- gropat të cilat janë hapur për rregullimin e gypit të ujit nga dy javë kanë mbetur pa u rregulluar ka raste që as shirit nuk kanë vendosur.

**Hyriete Isufi** thekson:- a do të fillon nga data një qershor java kulturore.

**Arbenita Bajramaliu** thekson:- kemi filluar me procedurat e rregullta.

**Nora Xhoni** thekson:- kam dëgjuar që është gjetur një gyp i ujit që ka qenë i dëmtuar dhe është mirë me na njoftuar më konkretisht drejtoria për shërbime publike.

**Arsim Dernjani** thekson:- afërsisht i ka qe tri javë që është stabilizuar furnizimi me ujë por ka problem për shkak të reshjeve atmosferike por gradualisht në të ardhme do të zgjidhen.

**Sherif Berisha** thekson:- a mendohet në të ardhmen që gjithë këto gypa që janë me ra prej forme dhe me u vendosur një instalim i ri për ndryshme problem kemi me pasur. A ka gypa të azbesti që janë shpërndarës të ujit.

**Arsim Dernjani** thekson:- në takimet që do t'i kemi me përfaqësuesit e kompanisë Bifrukacioni do t'i shikojmë kërkesat që i kanë . Për çështje të gypave të azbestit nuk kam informacione.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:42.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit

Florim Shkreta

